



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

th ë r r e t

mbledhjen e **parë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **04.02.2016**, dhe do të fillojë në orën **15:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Këshillit të Drejtorëve (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues urban të lagjes "Mati 2";
2. Propozimvendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues urban të lagjes "Sofalia";
3. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të hollësishëm të lagjes "Kodra e Trimave 1";
4. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë;
5. Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut regional natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i mbrojtur "Gërmia";
6. Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta;
7. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksë;
8. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës;

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

9. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale;
10. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale;
11. Shqyrtimi i Raportit buxhetor për situatën ekonomiko-financiare të Komunës për periudhën janar - qershor 2015;
12. Shqyrtimi i Raportit buxhetor tremujor, korrik - shtator 2015;
13. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2014;
14. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të një pjese të SHML "Gjimnazi Matematikë" për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme "Atomi";
15. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private;
16. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
17. Propozimplani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
18. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete;
19. Të ndryshme.

KRYESUESI I KOMITETIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.